

## **AKTI I THEMELIMIT**

**DHE**

## **STATUTI I SHOQERISE**

### **“DENTAL HEALTH SERVICES ALBANIA” Sh.p.k.**

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Bisnesit”, ne te nenshkruarit shpallim si me poshte vijon:

#### **FORMIMI I SHOQERISE**

**Neni 1**

Formohet shoqeria e quajtur **“DENTAL HEALTH SERVICES ALBANIA” Sh.p.k.** (qe me poshte do te quhet “Shoqeria”) me ortake:

**Znj. Jorida Jubani**, shtetas shqiptar lindur me 04.06.1980 ne Shkoder, dhe banuese ne Tirane me nr personal nr. **I05604127T**, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar.

#### **SELIA E SHOQERISE**

**Neni 2**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen **Njesia Administrative Nr. 5, Rruga “Dervish Bej Mitrovica” , Pallati Kristi - Co, nr.6, Kati perdhe, Dyqani nr.1 , Tirane.** Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

#### **KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**

**Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar kohore, e cila fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQUERISE**

### **Neni 4**

Objekti i veprimtarise se shoquerise eshte si me poshte:

Zirkonium, terapi, ortopedi, kirurgji, ortodonci, implantologji dhe ekzaminime, eksport, import dhe tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te materialeve dhe medikamenteve, pajisjeve. Asistence teknike, mirembajtje dhe riparim te gjitha produkteve te permendura me siper.Laborator dentar.

### **Neni 5**

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

## **KAPITALI I SHOQUERISE**

### **Neni 6**

Kapitali fillestar i shoquerise është 2.000.000 ( dy milion ) leke dhe i ndarë në 1 (nje) kuote me vlore nominale 2.000.000 lekë. Cdo ortak ka të drejtën e votës.

Kontributi i ortakevut ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

- **Znj. Jorida Jubani** zoteron 1 kuote e barabarte me 100 % te kapitalit fillestar te shoquerise, me vlore 2.000.000 Leke.

### **Neni 7**

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

## **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).

### **Neni 9**

Ortaket e shoquerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoquerise per fitimin e realizuar.

### **Neni 10**

Kuotat e cdo anetari perputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e tij anetari i shoqerise mund t'ua ofroje te treteve. Anetaret e shoqerise kane perparesti per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise. Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim Administratorit duke saktesar cmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejtë me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e bleresit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njofimit te fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Edhe e drejta e perparese per nenshkrimin e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit.

E drejta e perparese per nenshkrimin e kuotave eshte ne proporcion me kuotat qe zoteron secili prej ortakeve ne kete shoperi. Administratori pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh dhe ne rast se ortaket do ti blejne keto kuota, i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjithe ose pjeserisht kuotat e tij. Transferimi dhe shitja e kuotave mund te behen me akte notieriale ose pa akt notierial dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

### **Neni 11**

Emertimi i shoqerise tregtare, forma ligjore e shoqerise, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqerise, emri i administratorit, duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoperi, nepermjet perdonimit te letres apo mjeteve elektronike, dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

### **Neni 12**

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve.
- 2- Administratori.

## **ASAMBLEJA E ORTAKOVE**

### **Neni 13**

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mund te thirret nga çdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 5% te kapitalit te shoqerise. Anetaret duhet te njoftohen me shkrese ose nepermjet postes elektronike, jo me vone se 7 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te

jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet e rendit te dites qe do te trajtohen ne mbledhje.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe jane dakort te marrin vendime pavaresisht parregullsise.

## TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

### Neni 14

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

#### 1) *Asambleja e Zakonshme:*

Mblidhet te pakten 1 here ne vit, dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Asambleja e zakonshme e ortakeve merr vendime te vlefshme kur jane prezent apo te perfaqesuar me prokure ortaket qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave ne kapitalin e shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme:

Asambleja e Zakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

- Ajo aprovon çdo lloj veprimi finanziar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Vendos edhe per cdo ceshtje tjeter qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise ose nuk eshte lene ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme

#### 2) *Asambleja e Jashtezakonshme:*

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do te merren nga ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhtme:

- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statutit.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj. dhe vendos ne lidhje me keto ceshtje;
- Vendos ne lidhje me çdo çeshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, marrje hua, vendosje hipoteke, barre siguruese etj .
- Vendos per pjesemarrjen ne shoqeri te tjera per hapje dege, filiale, zyra perfaqesimi etj .
- Si dhe çdo çeshtje tjeter qe nuk eshte ne kompetencen e Asamblese se Zakonshme.

### **Neni 15**

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme te Ortakeve te cilat jane marre ne nje mbledhje te thirrur ne menyre te rregullt dhe konform kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjithe ortaket e tjere, edhe per ata qe nuk kane diskutuar ose nuk kane qene dakord.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter qe nuk eshte administrator. Asnje i derguar nuk mund te perfaqesoje me shume se nje ortak.

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjeter me prokure te posacme.

### **Neni 16**

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

## **ADMINISTRIMI**

### **Neni 17**

Shoqeria administrohet nga administratori i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperseritjeje. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rr Ethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ua jep shprehimisht ortakeve.

Administrator i shoqerise eshte **Z. Jorida Jubani** me nr personal . **I05604127T**.

Administratori zgjidhet per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

### **Neni 18**

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### **Neni 19**

Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijt qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha rregjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Administratori eshte pergjegjes per administrimin e shoqerise dhe informon ortaket per ecurine e veprimtarise tregtare te shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

#### **MARREDHENIET E PUNES**

#### **Neni 20**

Maredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respekoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojnë Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te per gjigjen per demet qe i shkaktojnë kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

#### **Neni 21**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

## **EKSPERTEL OSE REVIZORET KONTABEL**

**Neni 22**

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

## **BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE**

**Neni 23**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mballet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashtet sipas dispozitave perkatese ligjore.

**Neni 24**

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

## **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

**Neni 25**

Ne rast se shoqeria prishet per cdo lloj arsyte Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe percatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

## **LIBRAT E SHOQERISE**

**Neni 26**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te organit administrativ
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

## **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 27**

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Bisnesit”, dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

**ORTAKU I SHOQERISE**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Soraida Jelborec". The signature is written in a cursive style with a horizontal line underneath it.

Tirane , me 21/08/2019